



HAPET RRUGA PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KQZ-ja 'VULOS' ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

FAQE 4-5



Pas sagës gati dymujore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar zgjedhjet e 9 shkurtit. Sipas rezultatit të certifikuar, Vetëvendosja (LV) në Kuvendin e Kosovës do të përfaqësohet

me 48 deputetë, PDK-ja me 24, LDK-ja me 20, AAK-Nisma me 8 dhe minoritetet me 20 deputetë. Pas këtij veprimi të KQZ-së, radha është te presidentja Vjosa Osmani, e cila ka 30 ditë kohë për ta thirrur

seancën konstituive të Kuvendit, më pas duhet të zgjidhet edhe qeveria e re. Në bazë të rezultatit zgjedhor, asnjëra parti nuk do të mund ta bëjë qeverinë pa marrëveshje koalicioni

**REVISTA KROATE
DEMANTON VUÇIQIN:
MARRËVESHJA
KOSOVË - SHQIPËRI -
KROACI U KOORDINUA
ME SHBA-në
DHE NATO-n** F.3



**ORAV: S'MUND
TA IMAGJINOJ
SE SI SERBIA APO
KOSOVA MUND TË
ANËTARËSOHEN
NË BE PA
NORMALIZIMIN E
MARRËDHËNIEVE** F.3



**SHTRENTIMI I MUNDSHËM I
RRYMËS, ME "EFEKT DOMINO"
NË EKONOMI** F.8

SPORT



**DRITA DEMOLON GJILANIN, SOT
ZHVILLOHEN DY NDESHJE** F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjykata e Bosnjës kërkon që Interpol-i të lëshojë fletarrestime për Dodikun dhe Stevandiğin

SARAJEVË, 27 MARS - Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës ka kërkuar të lëshohen fletarrestime ndërkombëtare përmes INTERPOL-it për presidentin e Republikës Serpska (RS), Millorad Dodik, dhe kryetarin e Kuvendit Popullor të këtij entiteti serb, Nenad Stevandiç. “Shpallja e fletarrestimit është në kompetencë të Zyrës Qendrore Kombëtare të INTERPOL-it”, është konfirmuar për “Radion Evropa e Lirë” nga Gjykata e Bosnjës.

Në një përgjigje të mëhershme për një rast tjetër, INTERPOL-i kishte thënë se nuk lëshon fletarrestime, por “me kërkesë të shteteve anëtare dhe pas kontrolleve të përputhshmërisë, INTERPOL-i lëshon njoftime ndërkombëtare për të kërkuarit që njëhej si “njoftime të kuqe” i alarmon policitë në gjithë botën për të arratisurit që kërkojnë ndërkombëtarisht dhe ndihmon në sjelljen e tyre para drejtësisë. Megjithatë, është në kompetencën e vendeve anëtare të INTERPOL-it për të vendosur nëse do të arrestojnë një person ose jo.

Nga Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës është bërë me dije se fletarrestimet ndërkombëtare janë kërkuar më 26 mars nga Prokuroria e Bosnjë e Hercegovinës, e cila i ngarkon Dodikun dhe Stevandiğin, bashkë me kryeministrin e RS-së, Radovan Vishkoviç, dhe “persona të tjerë”, për sulm ndaj rendit

kushtetues të Bosnjë-Hercegovinës. Si bazë për lëshimin e fletarrestimeve, Prokuroria e Bosnjës ka deklaruar se Dodiku dhe Stevandiçi, “duke shfrytëzuar pozitën e tyre të larta në entitetin Republika Serpska, duke shmangur procedurat ligjore të kontrollit kufitar, kanë kaluar kufirin shtetëror dhe kanë lëshuar territorin e Bosnjë e Hercegovinës”. Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës ka deklaruar se Dodiku aktualisht ndodhet në Izrael, ndërsa i Stevandiçi, duke shmangur kontrollet ligjore, është kthyer nga Serbia në Bosnjë më 18 mars.

“Të gjitha rrethanat tregojnë se ka gjasa që Dodiku dhe Stevandiçi në çdo moment të ndodhen jashtë vendit”, është thënë nga Gjykata e Bosnje e Hercegovinës.

Dodiku, Vishkoviçi dhe Stevandiçi janë të dyshuar për sulm ndaj rendit kushtetues dhe ndaj tyre janë lëshuar fletarrestime qendrore brenda Bosnje e Hercegovinës, siç është konfirmuar për “REL”-in më 17 mars. Çdo agjenci policore, nga 16 sa janë në Bosnjë-Hercegovinë, duhet t'i arrestojë ata.

Ku ndodhet Millorad Dodiku?

Dodiku ndodhet në Izrael, ku po merr pjesë në një konferencë për antisemitizmin në



Jerusalem, ndërkohë që ndaj tij është lëshuar fletarrestim në Bosnjë e Hercegovinë. Dodiku kishte udhëtuar për në Izrael të martën, me avionin e Qeverisë së RS-së, të nisur nga Beogradi.

Një ditë para kësaj, në rrethana ende të paqarta, ai kishte kaluar kufirin mes Bosnjës dhe Serbisë, kur kishte udhëtuar në Batajnicë, afër Beogradit, për të marrë pjesë në përkujtimin e përvjetorit të bombardimeve të NATO-s.

Policia kufitare e Bosnjës ka njoftuar se po zhvillon hetime lidhur me kalimin e kufirit nga Dodiku, duke theksuar se në pikën kufitare ndërkombëtare Raça mes Bosnjës dhe Serbisë nuk ka barriera kufitare.

Çfarë i parapriu kërkesës për fletarrestim?

Kërkesa për arrestimin e zyrtarëve më të lartë të RS-së vjen në një periudhë të trazuar që pasoi pasi më 26 shkurt Dodiku është dënuar në shkallë të parë nga Gjykata e Bosnjës me një vit burg dhe gjashtë vjet ndalim për të mbajtur funksione publike, për shkak të mosrespektimit të vendimeve të përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar në Bosnje. Një ditë pas aktgjykimit, Kuvendi Popullor i RS-së pati miratuar ligje jokushtetuese me të cilat, në territorin e entitetit, u përpoq që të ndalojë punën e Gjykatës

dhe Prokurorisë së Bosnjës, Agjencisë Shtetërore për Hetim dhe Mbrojtje (SIPA), si dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial.

Gjykata Kushtetuese e Bosnje e Hercegovinës më 7 mars ka vendosur masë të përkohshme dhe ndaloj zbatimin e ligjeve të miratuara nga Parlamenti i entitetit.

Pas kësaj, autoritetet e RS-së kanë vazhduar me veprime jokushtetuese, përfshirë shqyrtimin e një Kushtetute të re të entitetit në një seancë të Kuvendit më 12 mars, e cila parashikon që RS-ja të jetë “shtet”, themelimin e ushtrisë entitetit dhe shfuqizimin e Këshillit të Popullit të RS-së.

Trumpi, marrëveshje me Kinën? I ofron ulje të tarifave në këmbim të “TikTok”-ut

UASHINGTON, 27 MARS - Donald Trump ka lënë të hapur mundësinë e uljes së tarifave që ka vendosur ndaj Kinës për të siguruar shitjen e “TikTok”-ut nga kompania me pronësi kineze, “ByteDance”.

Trumpi ka thënë se është i gatshëm të zgjasë afatin e 5 prillit për të gjetur një blerës jo-kinez për platformën.

Në janar presidenti amerikan kishte vonuar zbatimin e një ligji të miratuar nën administratën e Biden për të ndaluar “TikTok”-un.

Legjislacioni, i cili është nënshkruar në vitin 2024, përmend arsyet e sigurisë kombëtare për urdhrin e shitjes ose ndalimit. “Në lidhje me ‘TikTok’-un, Kina do të duhet të luajë një rol në këtë, ndoshta në formën e miratimit, ndoshta, dhe unë mendoj se do ta bëjnë. Ndoshta do t’u bëj atyre një zbritje të vogël në tarifat ose diçka për t’i bërë ata ta bëjnë atë” u ka thënë Trumpi gazetarëve.

Trumpi ka theksuar se ai pret që të paktën skica e një

marrëveshjeje të arrihet deri në afatin e 5 prillit. Deklarata ka ardhur pasi ShBA-ja ka njoftuar taksa të reja prej 25 për qind të importit për të gjitha makinat dhe pjesët e makinave që hyjnë në ShBA, në një lëvizje që kërcënon të zgjerojë luftën tregtare globale, raporton “BBC”.

Pengesa më e madhe për të përfunduar një marrëveshje për shitjen e “TikTok”-ut, me vlerë dhjetëra miliarda dollarë, ka qenë gjithmonë siguri i marrëveshjes së Pekinit.



Estonia ndryshon Kushtetutën, rusët dhe bjellorusët nuk mund të votojnë në këtë vend



TALIN, 27 MARS - Parlamenti i Estonisë ka miratuar një ndryshim kushtetues që heq të drejtën e votës në zgjedhjet lokale për qytetarët që nuk janë shtetas të Bashkimit Evropian, kryesisht për qytetarët e Rusisë dhe Bjellorusisë.

Ky vendim i vendit baltik ka burim nga arsye sigurie dhe

nevoja për të kufizuar ndikimin rus, duke pasur parasysh se atje jetojnë më shumë se 83 mijë shtetas rusë, sipas shërbimit publik estonez “ERR News”.

Parlamenti mbështeti propozimin e Komitetit Kushtetues për ndryshimin urgjent të Kushtetutës. Procedura e përshpejtuar e

ndryshimit të Kushtetutës është mbështetur nga 92 deputetë nga 101, ndërsa shtatë kanë votuar kundër. Për miratimin e vendimit ishte e nevojshme shumica e katër-pesëdhjetë deputetëve të pranishëm, që do të thotë të paktën katër herë më shumë vota për sesa kundër.

REVISTA KROATE DEMANTON VUÇIQIN: MARRËVESHJA KOSOVË - SHQIPËRI - KROACI U KOORDINUA ME SHBA-NË DHE NATO-N

ZAGREB, 27 MARS - Kosova, Shqipëria dhe Kroacia javën e kaluar kanë nënshkruar në Tiranë një marrëveshje bashkëpunimi ushtarak. Për të, Serbia ka reaguar ashpër, duke thënë se është dashur të pyetet ajo, se është shkelur një marrëveshje e vitit 1996, se është kundër shtetit serb dhe se është bërë pa dijeninë e ShBA-së dhe të NATO-s. Mirëpo ministri i mbrojtjes nga shtetet nënshkruese kanë thënë se marrëveshja nuk ka për cak askënd, por synon forcimin e sigurisë në vendet respektive dhe ka për qëllim bashkëpunimin në aspektin e sigurisë mes vendeve nënshkruese.

Në këtë kontekst, revista kroate “Nacional” ka hedhur poshtë edhe pretendimin e Beogradit zyrtar se ajo është bërë pa aminin e ShBA-së dhe të NATO-s. “Bashkëpunimi i ri ushtarak mes Kroacisë, Shqipërisë dhe Kosovës, për të cilin ministri i

Mbrojtjes, Ivan Anushiq, javën e kaluar udhëtoi në Tiranë për ta nënshkruar deklaratën me ministrin e Mbrojtjes të Shqipërisë, Pirro Vengu dhe atë të Kosovës, Ejup Maqedonci, është dakorduar, ose më saktë u koordinua, me administratën e presidentit amerikan Donald Trump dhe me udhëheqjen e NATO-s”, ka shkruar kjo revistë, duke shtuar se një gjë e tillë i është konfirmuar jozyrtarisht nga një burim i lartë pranë Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë.

I pyetur nëse ishte e vërtetë që për deklaratën kishte rënë dakord me liderët e ShBA-së dhe të NATO-s, një burim i rangut të lartë pranë Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë ka shpjeguar: “Mund t’ju them se deklarata është koordinuar me ata me të cilët është dashur të koordinohet, që janë lojtarët e fortë brenda NATO-s dhe se kushdo që duhet të ishte në dijeni të kësaj nisme kroate,



është i njohur me të”. Ky informacion mohon drejtpërdrejt deklaratën e presidentit serb Aleksandër Vuçiq, i cili është “tërbuar” nga nënshkrimi i deklaratës, madje ka theksuar se nënshkrimi i

kësaj marrëveshjeje ishte shkelje e së ashtuquajturës marrëveshje nënrajonale për kontrollin e armëve të vitit 1996 dhe se Kroacia dhe Shqipëria pothuajse “me siguri nuk e informuan NATO-n për gjithçka”.

Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë ka thënë se “kjo iniciativë, e cila po zbatohet pa Serbinë, por me Prishtinën, paraqet një provokim të hapur dhe një shpërfillje të madhe të realitetit në terren”.

ORAV: S’MUND TA IMAGJINOJ SE SI SERBIA APO KOSOVA MUND TË ANËTARËSOHEN NË BE PA NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE



PRISHTINË, 27 MARS - Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, ka theksuar se Bashkimi Evropian (BE) është synimi i Serbisë dhe Kosovës. Për ta arritur këtë, sipas tij, dialogu është një kusht, ose më mirë një parakusht.

Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Aivo Orav, në një intervistë për “RTK2”, ka theksuar rëndësinë e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se ky proces është i një rëndësie vendimtare për të ardhmen.

“Nuk mund ta imagjinoj se si Serbia apo Kosova mund të anëtarësohen në Bashkimin Evropian pa normalizimin e marrëdhënieve”, ka theksuar Orav.

Ai ka theksuar se ky është një hap kyç drejt stabilitetit dhe

integritimit në strukturat evropiane. “Ndihma financiare ose paratë tona janë vetëm një mjet për të ndihmuar në zbatimin e reformave dhe për t’i ndihmuar të dyja palët të përgatiten për anëtarësim në Bashkimin Evropian”, ka theksuar ai.

Duke folur për formimin e qeverisë së re, Orav ka thënë se procesi i formimit të qeverisë shpeshherë pas zgjedhjeve zgjat shumë. “Kam dëgjuar ankesa se ky proces në Kosovë po zgjat shumë, por më e rëndësishmja është që vullneti i të gjithë votuesve të merret parasysh në mënyrë të duhur”, ka thënë Orav.

Sipas tij, është jashtëzakonisht e rëndësishme që rezultatet e zgjedhjeve të reflektojnë dëshirat e qytetarëve, pavarësisht nga kohëzgjatja e negociatave.

Ambasada e ShBA-së paralajmëron emigrantët ilegalë: Kush shkel ligjin amerikan do të kthehet në vendin e tij ose do të përballet me akuzë

PRISHTINË, 27 MARS - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka bërë një paralajmërim të rreptë për të gjithë emigrantët ilegalë. Duke cituar sekretaren e Sigurisë Kombëtare, Kristi

Noem, e cila ka deklaruar se “nëse po konsideroni të hyni ilegalisht në Amerikë, as mos e mendoni”, Ambasada e ShBA-së në Prishtinë ka theksuar se kushdo që shkel ligjin amerikan do të përballet me akuzë penale.

“Hyrja e paligjshme në Shtetet e Bashkuara nuk është një opsion. Ata që shkelin ligjin amerikan do të kthehen në vendin e tyre ose do të përballen me akuzë penale”, ka theksuar Ambasada e ShBA-së.





HAPET RRUGA PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KQZ-JA ‘VULOS’ ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

Pas sagës gati dymujore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar zgjedhjet e 9 shkurtit. Sipas rezultatit të certifikuar, Vetëvendosja (LV) në Kuvendin e Kosovës do të përfaqësohet me 48 deputetë, PDK-ja me 24, LDK-ja me 20, AAK-Nisma me 8 dhe minoritetet me 20 deputetë. Pas këtij veprimi të KQZ-së, radha është te presidentja Vjosa Osmani, e cila ka 30 ditë kohë për ta thirrur seancën konstituive të Kuvendit, më pas duhet të zgjidhet edhe qeveria e re. Në bazë të rezultatit zgjedhor, asnjëra parti nuk do të mund ta bëjë qeverinë pa marrëveshje koalicioni

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 27 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me 9 vota për dhe dy kundër të enjten ka certifikuar rezultatit e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, duke i hapur kështu rrugë formimit të institucioneve të reja. Anëtarët e Vetëvendosjes në KQZ kanë votuar kundër certifikimit të zgjedhjeve. Pavarësisht prej kësaj, në këtë mbledhje të KQZ-së është bërë edhe zëvendësimi i kandidatëve që kanë fituar mandat të deputetit, por kanë vendosur të mos e ushtojnë këtë pozitë. Certifikimi i këtyre zgjedhjeve është bërë pasi kanë kaluar të gjitha afatet e ankesave të partive dhe kandidatëve për deputetë në Panelin për Ankesa dhe Parashtrësja dhe në Gjykatën Supreme. Sipas rezultateve të certifikuar, Lëvizja Vetëvendosje (LV) në

Kuvendin e Kosovës do të përfaqësohet me 48 deputetë, PDK-ja me 24, LDK-ja me 20 deputetë, AAK-Nisma me 8 dhe minoritetet me 20 deputetë. Në bazë të këtyre rezultateve, i bie që asnjëra parti nuk do të mund ta formojë e vetme qeverinë, por për ekzekutivin e ri do të duhet të formohen koalicionet.

Konstituimi i Kuvendit të ri të Kosovës

Procedurat për formimin e institucioneve të reja janë të parapara në Kushtetutë dhe ligje të tjera. Menjëherë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, hapi i parë nuk është formimi i qeverisë, por ai i konstituimit të përbërjes së re parlamentare. Sipas Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, presidentja e

Kosovës, Vjosa Osmani, duhet që brenda 30 ditësh ta thërrasë seancën konstituive të Kuvendit. Gjatë kësaj seance deputetët e rinj bëjnë betimin dhe më pas zgjedhin kryetarët dhe

nënkryetarët. Posti i kryetarit të Kuvendit i takon partisë së parë në zgjedhje, në këtë rast LV-së, ndërsa partitë më të mëdha politike propozojnë një kandidat për nënkryetar, por edhe deputetët e komunitetit serb dhe ata të komuniteteve joshumicë duhet të propozojnë nga një deputet për postin e nënkryetarit. Kryetari dhe nënkryetarët zgjidhen me shumicë të votave. Seanca konstituive, sipas Rregullores së Kuvendit, përfundon me zgjedhjen e tyre. “Ndërprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë”, thuhet në Nenin 12, pika 5 e Rregullores së Kuvendit.

Hamza, Muhaxheri e Ahmeti heqin dorë nga pozita e deputetit, zëvendësohen nga Qalaj, Gashi dhe Guri

Kryetari i Mitrovicës dhe ish-kandidati për kryeministër nga radhët e PDK-së, Bedri Hamza, kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri si dhe kryetari i Lipjanit, Imeri Ahmeti, kanë hequr dorë nga pozita e deputetit të zgjedhur në zgjedhjet e 9 shkurtit. Hamza në Kuvend do të zëvendësohet

nga Rashit Qalaj, Gazmend Muhaxheri nga Arben Gashi dhe Imri Ahmeti do të zëvendësohet nga Paris Guri. Po ashtu, Alban Zogaj ka dorëzuar dorëheqjen e tij nga pozita e nënkryetarit të Prishtinës për ta ushtruar mandatin e deputetit nga radhët e LDK-së.

Kufizimi i kompetencave të ekzekutivit aktual

Me konsituimin e Kuvendit, hapet rruga për formimin e ekzekutivit të ri. Por, në këtë periudhë të ndërmjetme - pra nga konstituimi i përbërjes së re parlamentare e deri te formimi i ekzekutivit të ri - qeverisë aktuale i kufizohen kompetencat. Këto kufizime parashihihen në nenin 31 të Ligjit për Qeverinë. Në këtë nen thuhet se qeveria nuk ka të drejtë të miratojë nisma apo të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare, për të cilat kërkohet ratifikimi i Kuvendit, nuk mund të miratojë ligje, strategji e koncept-dokumente, nuk mund të propozojë kandidatë për poste të caktuara, as të emërojë njerëz në pozita publike.

Qeveria e re

Në këtë periudhë presidentja Osmani, sipas ligjeve, obligohet ta nominojë partinë fituese si mandatarë për formimin e qeverisë së re. Kabineti qeveritar i propozuar duhet t'i sigurojë votat e 61 deputetëve. Sipas rezultateve përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja më 15 mars, LV-ja ka fituar 42.30 për qind, pasuar nga Partia Demokratike e

Myftiu Tërnavë, apel për ndalimin e vrasjeve në Kosovë

PRISHTINË, 27 MARS - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiu Naim Tërnavë, ka shprehur shqetësimin e tij për rastet e fundit të vrasjeve që ndodhën në vend, duke bërë thirrje që të ndalen rastet e tilla.

Në njoftimin e BIK-ut është thënë se Tërnavë u ka shprehur ngushëllime familjarëve të të vrasurëve, “duke lutur Zotin që këto të jenë rastet e fundit të vrasjeve në vendin tonë”.

Ndër të tjera, BIK-u ka bërë me dije se të enjten ka mbajtur mbledhjen e rregullt, ku është shqyrtuar

raporti i punës së Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për periudhën 1 janar 2024 - 31 dhjetor 2024, më pas është shqyrtuar edhe raporti i Komisionit Financiar të Kuvendit të BIK-ut, si dhe është shqyrtuar raporti i Pasqyrës për të hyrat dhe të dalat e kryesisë (llogaria përfundimtare) për vitin 2024.

“Pas diskutimeve të përgjithshme nga anëtarët e Kuvendit të BIK-ut, këto raporte u miratuan me votat e anëtarëve të Kuvendit. Gjatë kësaj mbledhje, një fjalë rasti para anëtarëve të

Kuvendit e mbajti edhe kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili paraqiti një raport të përgjithshëm mbi mbarëvajtjen e punëve të Bashkësisë Islame të Kosovës, veçanërisht gjatë këtij muaji të bekuar Ramadan. Në fund të mbledhjes, me propozimin e Myftiut Tërnavë, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, shprehu shqetësimin e tij për rastet e fundit të vrasjeve që ndodhën në vendin tonë, duke bërë apel që të ndalen rastet e tilla.



Myftiu Tërnavë u shprehu ngushëllime familjarëve të të vrasurëve, duke lutur Zotin që

këto të jenë rastet e fundit të vrasjeve në vendin tonë”, ka njoftuar BIK-u.

KOS: RRUGËTIMI I SHQIPËRISË NË BE MUND TË PËRFUNDOJË NË FUND TË VITIT 2027, SERBIA NË NGEÇJE

Prishtinë, 27 mars - Komisionarja e BE-së për Zgjerim, Marta Kos, ndodhet në një vizitë disaditore në Slloveni. Në një intervistë për mediumin slloven “RTV SLO”, Kos ka folur për tensionet në Ballkanin Perëndimor dhe sfidat që përballet Bashkimi Evropian (BE). Ajo ka thënë se zgjerimi i Bashkimit Evropian ishte një çështje gjeopolitike dhe jo vetëm një proces teknik, duke shtuar se Shqipëria mund ta kalojë vijën e finishit deri në fund të vitit 2027.

“Ballkani Perëndimor është në plan të parë. Personalisht, më dhemb shumë që procesi i zgjerimit në Ballkanin Perëndimor nuk ka ndodhur për kaq shumë vjet. Dy vende janë në krye, njëri është Mali i Zi, me të cilin mund t'i përmbyllim negociatat deri në fund të vitit 2026 dhe më pas varet nga shtetet anëtare se sa kohë do të



duhet për ratifikim. Aktualisht, Shqipëria është në vendin e dytë, e cila mund ta kalojë vijën e finishit në fund të vitit 2027”, ka thënë ajo, duke treguar numrin e personave që punojnë në Bruksel për një vend

kandidat për në BE. “Rreth një mijë njerëz punojnë për një vend kandidat në Bruksel nga të gjitha fushat. Këto janë aftësi teknike, por në fund do të vendosin shtetet anëtare. Dhe jam e vetëdijshme për

rëndësinë e jashtëzakonshme të komunikimit, pasi nuk mund ta imagjinoj që pas të gjitha negociatave në një shtet anëtar, të themi jo dhe se nuk e duam këtë vend në Bashkimin Evropian. Ne, gjithashtu, do të

duhet të bëjmë shumë punë në këtë fushë”, ka thënë Kos.

Kos ka thënë se kjo ishte hera e parë që po zhvilloheshin negociatat me një vend në luftë - Ukrainën dhe se forcat e jashtme po përpiqeshin ta pengonin procesin e zgjerimit. Ajo ka vlerësuar se BE-ja duhej t'u përgjigjej edhe çështjeve të sigurisë, mbrojtjes dhe stabilitetit global.

Kos ka thënë se beson se Serbia është në ngeçje në rrugën e saj evropiane dhe se protestat tregonin se populli dëshiron ndryshim. “Serbia është në stagnim në rrugën e saj evropiane” ka thënë Kos pas takimit me presidentin Aleksandër Vuçiq në Bruksel. Pas protestave masive, Kos ka thënë se BE-ja ishte me popullin. “BE-ja do të japë 16 milionë euro shtesë për organizatat joqeveritare në Serbi”, është shprehur Kos.

BE-ja: Kosova dhe Serbia ende s'kanë marrë parafinancim nga Plani i Rritjes

Bruksel, 27 mars - Kosova dhe Serbia ende nuk kanë pranuar parafinancim në kuadër të Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian, ka bërë me dije zëdhënësi i BE-së, Guillaume Mercier. Gjatë një konference për medie, Mercier ka theksuar se procesi për Prishtinën dhe Beogradin është ende në vazhdim. Ai ka thënë se Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kanë marrë

parafinancim gjatë ditëve të fundit. “Mund të konfirmoj se në këtë fazë nuk ka parafinancim për Serbinë dhe Kosovën. Ka pasur parafinancim në fillim të kësaj jave dhe javën e kaluar për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, por procesi është ende në vazhdim për të dy vendet - për Kosovën dhe Serbinë”, ka thënë Mercier. Sipas tij, një nga parakushtet

kryesore për përfitimin nga ky fond është përparimi në dialogun mes dy vendeve. “Në fakt, në procedurën për Planin e Zgjerimit ka një parakusht kur është fjala për Kosovën dhe Serbinë, që të angazhohen në dialog konstruktiv në kontekstin e marrëdhënieve. Në këtë fazë nuk mund t'ju them nëse kushti është përmbushur apo jo”, ka thënë Mercier.



Kosovës me 20.95 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës me 18.27 për qind. Në vendin e katërt është koalicioni në mes të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate me 7.06 për qind.

Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - ka siguruar 4.26 për qind të votave. Me këto përqindje, LV-

ja i ka siguruar 48 ulëse në Kuvendin e Kosovës, PDK-ja 24 sosh, LDK-ja 20 vende, Lista Serbe nëntë vende dhe koalicioni AAK-Nisma, tetë vende. Pra, i bie që asnjëra parti nuk do të mund ta formojë e vetme qeverinë, por për ekzekutivin e ri do të duhet të formohen koalicionet.

Sa iu përket koalicionëve, LV-ja ka thënë se pëlqen ta formojë

qeverinë me partitë joshumicë - të cilat kanë dhjetë ulëse të garantuara në Kuvendin e Kosovës.

Partitë e mëdha shqiptare, po ashtu, janë shprehur kundër bashkëpunimit për ekzekutivin e ri me LV-në. Por, Kurti ka shprehur bindjen se do ta udhëheqë qeverinë e re. Megjithatë, nëse LV-ja dështon ta sigurojë mbështetjen e 61

deputetëve, atëherë presidentja Osmani është e obliguar që brenda dhjetë ditësh t'i ftojë në konsultime partitë politike.

Pas konsultimeve është në diskrecionin e saj për të vendosur për mandatarin e ri, nëse ai dëshmon se ka numrat për ta formuar ekzekutivin. Mandatari më pas i ka 15 ditë kohë që t'i paraqesë Kuvendit

përbërjen e kabinetit qeveritar, por nëse qeveria nuk formohet as pas tentimit të dytë, atëherë presidentja Osmani, sipas nenit 95 të Kushtetutës, duhet t'i shpallë zgjedhjet e reja të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 40 ditë. Zgjedhjet e 9 shkurtit ishin zgjedhjet e para të rregullta parlamentare të mbajtura në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë.

Parandalohet futja e substancave narkotike në burgun e Dubravës

PRISHTINË, 27 MARS - Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) ka njoftuar se ka parandaluar një rast të futjes së substancave të dyshuara narkotike në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Sipas njoftimit të ShKK-së, gjatë patrullimit të perimetrit të jashtëm, stafi i sektorit të sigurisë në këtë qendër ka

arritur ta parandalojë futjen e një sasive të substancës së dyshuar narkotike. “Falë informacioneve të brendshme dhe vigjilencës së stafit, tentativa për kontrabandim është zbuluar dhe neutralizuar në kohë. Lidhur me rastin, janë njoftuar autoritetet kompetente, të cilat kanë nisur

hetimet për identifikimin e përgjegjësve. Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) mbetet i përkushtuar për të parandaluar çdo tentim për futjen e sendeve të ndaluara në institucionet korrektuese, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe të rregullt”, ka njoftuar ShKK-ja.



‘CORRWATCH’ REAGON PAS EMËRIMIT TË DREJTORIT TË AKREDITIMIT NË MINT: PROCESI REKRUTUES ËSHTË I PALIGJSHËM

PRISHTINË, 27 MARS - Iniciativa “CorrWatch” ka kritikuar qeverinë Kurti për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë të Përgjithshme të Akreditimit në MINT. Përmes një reagimi, kjo iniciativë ka shprehur shqetësime lidhur me këtë emër. Sipas Iniciativës “CorrWatch”, emërimi i drejtorit të Akreditimit, Irfan Lipovica, përmes një procesi rekrutues të paligjshëm, minon integritetin në administratën publike. “CorrWatch” ka reaguar publikisht edhe më 26 nëntor 2024 duke kërkuar rishqyrtimin e procesit. Kjo pasi që ‘CorrWatch’ kishte evidentuar se MINT ka shkelur Ligjin për Zyrtarët Publikë, duke përfshirë në listën e ngushtë kandidatë që nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në shpalljen e konkursit, veçanërisht kërkesat



për përvojën e punës në pozita drejtuese. Në listën e ngushtë të rezultateve të verifikimit

paraprak ishin përfshirë dy (2) kandidatë, por vetëm njëri prej tyre i kishte plotësuar kushtet

ligjore. Përkundër kësaj, në vend se të anulohet procesi për shkak se kishte vetëm një

kandidat i cili kishte plotësuar kriteret, dy kandidatët u shpallën fitues për të kaluar në fazën finale të emërimit”, është thënë në reagimin e kësaj iniciative, duke shtuar se qeveria nuk ka marrë parasysh shqetësimet e tyre. “Pavarësisht shqetësimeve të ngritura dhe shkeljeve të identifikuar, qeveria sot ka emëruar njërin nga kandidatët, duke legjitimuar një proces të parregullt dhe të paligjshëm. Ky emërim jo vetëm që legjitimon një procedurë të paligjshme, por gjithashtu shkel parimet e integritetit dhe meritokracisë në administratën publike. ‘CorrWatch’ kërkon anulimin e menjëhershëm të këtij emërimi dhe një reflektim dhe përgjegjësi institucionale mbi shkeljet e evidentuara”, është thënë në reagimin “CorrWatch”.

MUAJI I RAMAZANIT PËRFUNDON NESËR, BAJRAMI FESTOHET PASNESËR



PRISHTINË, 27 MARS - Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) ka njoftuar opinionin e gjerë se muaji i madhëruar Ramazan përfundon nesër (e shtunë), ndërsa dita e parë e festës së Fitër Bajramit do të festohet pasnesër (e diel). BIK-u ka njoftuar se manifestimi qendror për festën e Fitër Bajramit për Republikën e Kosovës do të mbahet në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. “Manifestimi fillon në orën 05:41, me faljen e namazit të sabahut, të cilit do t'i prijë Hetem ef. Sopjani, pas të cilit do të jetë ligjërata tematike kushtuar kësaj feste nga Agim ef. Hyseni - anëtar i Kryesisë së BI-së së Kosovës. Namazi i Fitër Bajramit falet në orën

06:59 minuta, të cilit do t'i prijë Vedat ef. Sahiti - kryeimami i BIK-ut. Hytben e Fitër Bajramit do ta mbajë Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavi, i cili do t'u drejtohet opinionit të gjerë me mesazh për këtë festë”, ka njoftuar BIK-u. Sipas këtij njoftimi, me rastin e festës së Fitër Bajramit, ditën e parë, më 30 mars 2025, Kryesia e BIK-ut, si tradicionalisht, organizon pritje urimi në selinë qendrore të BIK-ut nga ora 9:00-12:00. “Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ua uron festën e Fitër Bajramit të gjithë besimtarëve dhe opinionit të gjerë, duke e lutur Zotin që t'i ketë pranuar agjërimit, lutjet dhe ibadetet tona. Me fat festa e Fitër Bajramit!”, ka njoftuar BIK-u.

Bordi i KRU ‘Gjakova’ e largon përkohësisht nga puna kryeshefin Hasan Krasniqi

PRISHTINË, 27 MARS - Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Gjakova” e ka larguar përkohësisht nga puna kryeshefin e kësaj kompanie,

Hasan Krasniqi. “Për kohën e largimit të përkohshëm nga puna, komform nenit 74 të Ligjit të Punës, i punësuar kompensohet në lartësi prej 50

për qind të të ardhurave personale”, është thënë në vendim. Më tutje është bërë me dije se largimi i përkohshëm nga puna vlen

për 6 muaj më së shumti. Krasniqi është arrestuar më 18 mars, pasi dyshohet se ka kryer veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.



LANSOHET PILOTIMI I SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA PËR NGJARJEN JETËSORE TË LINDJES SË FËMIJËS

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 MARS - Të enjten është bërë lansimi i pilotimit të shërbimeve të integruara për ngjarjen jetësore të lindjes së fëmijës, me pjesëmarrjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti, shefit të zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav dhe ambasadorit të Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde. Kjo nismë e Qeverisë së Kosovës është mundësuar përmes projektit të mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe qeveria gjermane, ndërsa zbatohet nga GIZ.

Në fjalën e tij hyrëse, kryeministri Kurti ka thënë se janë duke hapur një kapitull të ri në mënyrën se si shteti ofron shërbime publike më të afërta me qytetarin, më të koordinuara, më të thjeshta dhe digjitale. “Me zgjidhjen që po pilotojmë sot, prindërit nuk kanë më nevojë të shkojnë nga një sportel në tjetrin për të kryer procedura të ndryshme. Të gjitha të dhënat e nevojshme për regjistrimin e

fëmijës, për benefitet që u takojnë, për sistemin shëndetësor e për vaksinimin, mbledhen që në spital, në momentin e lindjes, dhe shpërndahen automatikisht te institucionet përkatëse”, ka thënë Kurti.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka deklaruar se digjitalizimi i shëndetësisë mbetet një nga prioritetet kyçe të transformimit publik në vendin tonë. Krahas pilotimit të shërbimeve që janë paraqitur të enjten, ai ka treguar për një arritje e veçantë siç është digjitalizimi i fletores së fëmijës, e cila do të lansohet së shpejti në platformën “e-Kosova”.

Ndërsa shefi i zyrës së BE-së në Prishtinë, Aivo Orav, ka thënë se Kosova ka bërë një hap të madh përpara me lansimin e shërbimit të saj të parë proaktiv të ngjarjeve të jetës, duke filluar me regjistrimin e lindjes së fëmijëve. “Kjo do të thotë se proceset si regjistrimi i të porsalindurve, qasja në përfitimet e lehonisë dhe caktimi i vaksinimeve do të jenë



tani më të thjeshta dhe më të shpejta. BE-ja është krenare të mbështesë Kosovën në këtë udhëtim digjital, duke ndihmuar në lehtësimin e jetës së përditshme duke hapur mundësi të reja për rritje”, ka thënë Orav.

Në mesin e folësve në këtë ngjarje ishte edhe ambasadori gjerman në Kosovë, Rohde. Ai ka shprehur nderim që është i

pranishëm për të shënuar këtë arritje të rëndësishme në rrugëtimin e Kosovës drejt përmirësimit dhe digjitalizimit administratës publike.

Shërbimet që përfshihen nga lansimi i pilotimit janë: regjistrimi i lindjes në regjistrin civil, aplikimi për përfitimet për nënën dhe fëmijën, regjistrimi në sistemin shëndetësor, regjistrimi i vaksinave, hapja e

llogarive në “e-Kosova” për prindërit dhe njoftimi elektronik i institucioneve statistikore dhe shëndetësore. Në kuadër të kësaj nisme, në platformën “e-Kosova” është krijuar edhe një seksion i veçantë për lindjen e fëmijës, ku qytetarët mund të informohen dhe të planifikojnë faza të ndryshme të kësaj periudhe – nga para-shtatzënia deri te kujdesi pas lindjes.

OSMANI VIZITON NËNËN FERDONIJE NË 26-VJETORIN E RRËMBIMIT TË DJEMVE DHE BURRIT TË SAJ NGA SERBIA

GJAKOVË, 27 MARS - Presidentja Vjosa Osmani ka vizituar të enjten nënën Ferdonije në shtëpinë-muze të familjes Çerkezi në Gjakovë. Kjo vizitë e Osmanit ndërlidhet me 26-vjetorin e rrëmbimit të dhunshëm nga regjimi gjenocidal serb të bashkëshortit dhe katër djemve të nënës Ferdonije.

Osmani ka thënë se me nënën Ferdonije i kanë takuar nënat e Gjakovës të cilat kanë humbur të dashurit e tyre nga krimet e Serbisë. “Në 26-vjetorin e rrëmbimit të dhunshëm nga regjimi gjenocidal serb të bashkëshortit dhe 4 djemve të saj, sot isha për vizitë te nëna Ferdonije në shtëpinë-muze të familjes Çerkezi në Gjakovë. Bashkë me Nënë Ferdonije takuam edhe nënat e tjera të Gjakovës të cilat kanë humbur të dashurit e tyre nga krimet makabre të Serbisë. Eshtrat e dy djemve të Nënë Ferdonije janë gjetur, teksa fati i bashkëshortit dhe dy djemve të tjerë vazhdon të mbetet peng. Megjithatë, ajo nuk është



dorëzuar. Dhimbjen e ka shndërruar në forcë, stoicizëm dhe në kauzë për drejtësi. Dhimbja e saj është edhe e jona. Kauza e saj është edhe e jona. Dhimbje e kauzë e gjithë Kosovës”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.

Për rrëmbimin e familjarëve të nënës Ferdonije ka reaguar të enjten edhe kryeministri Albin Kurti. Ai ka thënë se nëna Ferdonije është simbol i qëndresës sonë kombëtare. “Familja gjashtë anëtarëshe Qerkezi kishte traditë të bukur:

çdo datë të veçantë e shënonte si festë. Kaq falënderues ishin për çdo bekim që jeta u kishte dhënë. Festojë çdo ditëlindje e festë tjetër në familjen e ngushtë, e që ishte mjaft e madhe. Tash, Nëna Ferdonije e jeton pesëfish vetminë. Katër

djemtë dhe burrin nuk i sheh. I mungojnë çdo ditë, mëngjes e mbrëmje. Nuk i ka. Tash, ajo e ka një popull të tërë krah saj. Ne të gjithë e mendojmë, e kujtojmë dhe bashkëndiejmë me të gjithmonë, por sidomos më 27 mars. Kjo është data që tani shënon Nëna Ferdonije. Dita kur në vitin 1999 ajo pa për herë të fundit pesë anëtarët e familjes, bijtë e saj të shtrenjtë: Artanin, Armendin, Ardianin e Edmondin dhe bashkëshortin e dashur Halimin. Ata u rrëmbyen me dhunë dhe u zhdukën nga forcat e armatosura të Serbisë. Shtëpia e familjes Qerkezi tani është muze. Datat që shënohen, janë ditët e kujtesës dhe dhembjes. Nëna Ferdonije është simbol i qëndresës sonë kombëtare. Zemra e saj është dëshmia më e fortë e qëndresës njerëzore. Ajo vetë është ruajtësja e fuqishme e kujtesës për gjenocidin serb në Kosovë. Dhembja e saj është detyrimi ynë, që kurrë të mos harrojmë!”, ka shkruar Kurti në rrjetet sociale.

APK-ja, thirrje zyrtarëve ta deklarojnë pasurinë, paralajmëron gjoba dhe kallëzime penale

PRISHTINË, 27 MARS - Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) u ka bërë thirrje të gjithë zyrtarëve që ende s'e kanë deklaruar pasurinë, ta bëjnë një gjë të tillë, duke ua rikujtuar se mund të

përballen me pasoja ligjore, gjoba dhe kallëzime penale. Procesi i deklarimit të rregullt të pasurisë për zyrtarët e lartë publikë përfundon më 31 mars. Në njoftimin e APK-së është bërë me dije se deri më tani

6 420 zyrtarë e kanë deklaruar pasurinë, ndërsa 1 714 janë në proces e sipër. “Procesi i deklarimit të pasurisë ka filluar më 1 mars dhe përfundon më 31 mars. Deri më tani, 6420 zyrtarë kanë deklaruar

pasurinë, ndërsa 1714 janë në proces. Apelohen të gjithë zyrtarët që ende nuk kanë përfunduar deklarimin ta bëjnë sa më shpejt, pasi mosdeklarimi sjell pasoja ligjore, gjoba dhe kallëzime penale”, ka njoftuar APK-ja.



Shtrenjtimi i mundshëm i rrymës, me ‘efekt domino’ në ekonomi

PRISHTINË, 27 MARS - Nga muaji i ardhshëm rryma në Kosovë mund të shtrenjtohet për 15 për qind, por zinxhiri i shtrenjtimit nuk do të ndalet. Bizneset, sidomos prodhueset, do të përballen me rritje të kostove operative, duke i detyruar ato t'i rrisin çmimet e produkteve dhe të shërbimeve.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) në Kosovë ka paralajmëruar se nga muaji prill faturat e energjisë elektrike mund të rriten për 15 për qind. Aktualisht për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi i rrymës gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat. Në rast të shtrenjtimit për 15 për qind, ata do të paguanin 8.96 centë. ZRRë-ja i shqyrton dhe cakton tarifën e energjisë elektrike çdo vit dhe ato janë në fuqi nga 1 prilli deri më 31 mars të vitit pasues. Sipas këtij institucioni, rritja e tarifave këtë vit është e domosdoshme për shkak të uljes së prodhimit të energjisë, rritjes së konsumit dhe varësisë së madhe nga importet me çmime të larta.

Çmimet aktuale të energjisë

Në prill të vitit të kaluar ZRRë-ja ka ulur çmimin e energjisë për konsumatorët komercialë dhe industrialë për 3 për qind. Megjithatë, një vit më parë, më 2023, tarifën janë rritur për 15 për qind për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Aktualisht për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në muaj, çmimi i

rrymës gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat. Për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë llogarit me çmim prej 14.45 centësh.

Ndërkaq, nga ora 22:00 deri në 7:00 të mëngjesit, çmimi për kilovat është 3.34 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë dhe 6.81 centë për ata që shpenzojnë më shumë. Kosova nuk mund ta sigurojë energjinë e nevojshme për mbi 1.6 milion banorët e saj vetëm me prodhimin nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Një nga arsyt është vjetërsia me dekada e termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B”.

Prodhim ka edhe përmes burimeve të ripërtërishme, por në sasi më të vogla. Prodhimi i pamjaftueshëm bën që një pjesë e konsiderueshme e furnizimit të sigurohet përmes importeve, që janë të shtrenjta. Më 26 mars çmimi i energjisë elektrike në bursën hungareze HUPX, nga importon Kosova, ishte 118 euro për megavat.

Ndikimi të bizneset dhe rritja e çmimeve

Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Biznesit, ka thënë se rritja e çmimit të energjisë elektrike do t'i rrisë kostot operative të bizneseve, veçanërisht atyre prodhuese. Për shembull, një kompani që deri tani ka paguar 1 000 euro në muaj për energji, pas shtrenjtimit do të paguajë 1 150 euro, sipas tij. Shahini ka thënë se kjo do t'i detyrojë bizneset t'i rrisin çmimet e produkteve dhe



shërbimeve të tyre, duke i bërë ato më pak konkurruese në treg. Për më tepër, thotë ai, këto biznese mund të shkurtrojnë edhe vende pune, për t'i mbuluar shpenzimet shtesë. “Kjo rritje do të ndikojë në çmimet e produkteve esenciale, si: buka, qumështi, vaji, lëngjet dhe shërbimet e ndryshme. Bizneset nuk janë fajtorët kryesorë për këtë rritje - shkak kryesor mbetet rritja e çmimit të energjisë”, ka thënë Shahini për “Radion Evropa e Lirë”.

Kosova, viteve të fundit, është përballur me rritje të vazhdueshme të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve. Shtrenjtimi ka nisur në kohën e pandemisë Covid-19 në vitin 2020 dhe ka marrë hov pasi Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës, më 2022.

Rritje të tjera të çmimeve të produkteve paralajmëron edhe Gani Durmishi, kryetar i

Shoqatës së Prodhuesve dhe Përpunuesve të Qumështit në Kosovë.

“... sepse kur shtrenjtohet energjia elektrike, ngrihet edhe çmimi i ambalazhit, ngrihet edhe çmimi i qumështit. E, pastaj, kur të rritet kostoja e shpenzimeve jetësore, edhe punëtorët kërkojnë paga më të larta”, thotë ai.

“Radio Evropa e Lirë” ka biseduar me disa qytetarë në fund të muajit të kaluar, kur nisi të flitej për shtrenjtimin e mundshëm të rrymës, dhe shumica thanë: “Nuk e dimë se si do t'ia dalim”.

Valë e re çmimesh edhe në qershor?

Pas shtrenjtimit të pritshëm të rrymës në prill, bizneset në Kosovë do të përballen edhe me një ndryshim tjetër të rëndësishëm pas dy muajsh. Nga 1 qershori, kompanitë me

më shumë se 50 punëtorë ose një qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro, do të kenë mundësi të zgjedhin furnizuesin e tyre të energjisë dhe të dalin në tregun e hapur. Ky hap është pjesë e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, por ka ngjallur shqetësime mes afaristëve dhe organizatave të biznesit, që paralajmërojnë për çrregullime ekonomike dhe rritje të çmimeve.

Në një prononcim për “Radion Evropa e Lirë”, më 12 mars, Alajdin Fusha, pronar i kompanisë “ABI ShPK” në Prizren, ka thënë se me kalimin në treg të hapur, do të bëhet e pashmangshme rritja e çmimeve të produkteve.

Kjo, për faktin se çmimi për kilovat nuk mund të pritet nën 15 centë, nga rreth 7 centë sa paguan kompania tash për tash, sipas tij. “Me doemos do të reflektojë edhe në koston e produkteve dhe shërbimeve”, ka thënë Fusha, firma e të cilit operon me 13 kompani që ofrojnë produkte ushqimore dhe shërbime të tjera.

Këtë shqetësim e kanë ngritur edhe Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit, të cilat kanë rekomanduar shtyrjen e zbatimit të tregut të hapur të energjisë, duke argumentuar se vendi nuk është ende gati për këtë ndryshim.

ZRRë-ja, megjithatë, ka insistuar se ka licencuar kompani të mjaftueshme për furnizim me energji elektrike dhe është zotuar se do t'i monitorojë vetë marrëveshjet mes bizneseve dhe kompanive furnizuese, për të shmangur abuzimet e mundshme.

Tatimi në pronë dhe paralajmërimi për shtrenjtimin e rrymës, AKK-ja: Po rëndohet buxheti i qytetarëve dhe bizneseve

PRISHTINË, 27 MARS - Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) ka reaguar lidhur me paralajmërimin për shtrenjtimin e energjisë elektrike, duke thënë se po rëndohet buxheti i qytetarëve. Bordi i AKK-së ka theksuar se në kohën kur qytetarët dhe bizneset po përballen me sfida të shumta ekonomike, duke përfshirë edhe inflacionin, paralajmërimi për një tjetër shtrenjtim të energjisë elektrike paraqet një barrë shtesë për familjet e Kosovës si dhe për sektorin privat. “Ky vendim vjen pas rritjes së tatimit në pronë, pas rivlerësimit të pronës që është bërë nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ka rënduar buxhetin e qytetarëve dhe bizneseve që ka ndikuar edhe



në ekonominë lokale në komunat e Kosovës. Për më tepër, ka filluar edhe zbatimi i tatimit në tokën bujqësore,

duke krijuar një tjetër sfidë për fermerët dhe sektorin agro-industrial, të cilët janë një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit

ekonomik të vendit”, është thënë në reagimin e AKK-së. Sipas bordit të AKK-së, kombinimi i këtyre tre

faktorëve, rritja e çmimit të energjisë, rritja e tatimit në pronë dhe tatimi mbi tokën bujqësore, do të ndikojnë negativisht në mirëqenien e qytetarëve, duke rritur koston e jetesës dhe duke vështirësuar zhvillimin e bizneseve që ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në zhvillimin ekonomik lokal. “Kjo qasje e vazhdueshme e ngarkimit të qytetarëve me tatime të reja dhe tarifa të rritura në mënyrë periodike kërkon një koordinim ndër-institucional por dhe qasje më të balancuar, me qëllim që të mos dëmtohet edhe më tutje stabiliteti ekonomik dhe të ruhet mirëqenia e përgjithshme ekonomike e vendit dhe vetë pushtetit lokal”, është thënë në reagimin e AKK-së.

CIA KONFIRMON EKZISTENCËN E ARKËS SË BESËLIDHJES

(Dokumentet e deklasifikuara)

Në gjurmët e Indiana Jones

CIA pretendoi se kishte konfirmuar ekzistencën e Arkës së Besëlidhjes me anë të shikimit në distancë – i njohur ndryshe si perceptimi ekstra ndijor ose ESP – duke pretenduar se objekti misterioz dhe i shenjtë ruhet nga “entitete” me një fuqi “të panjohur”, pretendon një dokument i deklasifikuar së fundmi.

Në një seancë shikimi në distancë më 5 dhjetor 1988, shikuesi në distancë #32 u ngarkua të identifikonte një objektiv që, pa e ditur ata, doli se ishte Arka e Besëlidhjes, sipas dokumentit, i cili u deklasifikua më 8 gusht 2000 dhe ka qarkulluar në mediat sociale.

Nga ana logjistike, kur një shikues në distancë ngarkohet të kërkojë një objektiv, objekti i dëshiruar shkruhet në një copë letër dhe futet në një zarf. Shikuesi në distancë nuk e di se çfarë është shkruar dhe udhëhiqet përmes procesit nga një person tjetër, shpjegoi shefi në pension i ushtrisë amerikane, Joe McMoneagle.

“Informacioni i mbledhur sipas këtij protokolli është i vetmi informacion që mund të identifikohet si shikim në distancë,” tha McMoneagle.

McMoneagle, i njohur si shikuesi në distancë numër 1, ishte i pari që bëri eksperimentet e dukurive për CIA-n, dhe ai nuk është i bindur nga ushtrimi i përmendur në dokumentin e deklasifikuar.

Vizioni i shikuesit në distancë #32 përshkroi një vendndodhje sekrete të objektit në Lindjen e Mesme – që ata nuk e dinë se është Arka – por ata thonë se është “i mbrojtur nga disa entitete”, zbulon dokumenti.

“Objektivi është një enë. Kjo enë ka një enë tjetër brenda saj. Objekti është prej druri, ari dhe argjendi... në formë të ngjashme me një arkivol dhe është zbukuruar me serafime,” transmetojnë ata, sipas dosjes.

“Pamjet e ndërtesave përreth tregonin praninë e kupolave ??të xhamisë,” thanë ata, duke shtuar se burrat që flisnin arabisht, të veshur me të gjitha të bardha, popullonin zonën.

“Objektivi është i fshehur, nën tokë, errësira ??dhe lagështia ishin të gjitha aspektet e vendndodhjes së objektivit,” vijuan ata.

“Qëllimi i objektivit është të bashkojë një popull. Ka të bëjë me ceremoninë, kujtesën, homazhet, ringjalljen. Ekziston një aspekt i spiritualitetit, informacionit, mësimave dhe njohurive historike shumë përtej asaj që ne njohim tani.”

Shikuesi në distancë #32 më pas shpjegoi aspektet më misterioze të asaj që panë.

“Objektivi mbrohet nga subjektet dhe mund të hapet vetëm nga ata që janë të autorizuar për ta bërë këtë – ky kontejner nuk do/nuk mund të hapet derisa koha të konsiderohet e saktë. Pasi të jetë



koha për të hapur kontejnerin, mekanika e sistemit të bllokimit do zbulohet se është mjaft e thjeshtë,” thanë ata përpara se të shtonin një paralajmërim për grabitësit e mundshëm.

“Individët që hapin kontejnerin duke e këputur ose duke goditur shkatërrohen nga mbrojtësit e kontejnerit nëpërmjet përdorimit të një fuqie të panjohur për ne.”

Kanalizuesi gjithashtu përshkroi atë që ata e konsideruan si një aspekt devotshmërie të objektit.

“Qëllimi i objektivit është të

bashkojë njerëzit. Ka të bëjë me ceremoninë, kujtesën, homazhet, ringjalljen. Ekziston një aspekt i spiritualitetit, informacionit, mësimave dhe njohurive historike shumë përtej asaj që ne dimë tani,” thanë ata.

Dokumenti i deklasifikuar përfshinte gjithashtu disa faqe vizatimesh që përshkruajnë një nga katër serafinët që bien në sy në qoshet e Arkës, si dhe një vizatim mumjesh të rreshtuara në një mur.

“Përdorimi i shikimit në distancë kundër çdo objektivi për të cilin e

vërteta tokësore nuk ekziston ose është e pamundur të merret, si UFO-t, UAP-të, sipërfaqja e Marsit ose vendndodhjet e relikteve historike, është humbje kohe dhe burimesh,” tha McGoneagle për The Post.

“Nëse dikush pretendon se shikimi në distancë vërteton ekzistencën e diçkaje, siç është Arka e Besëlidhjes, ata duhet të prodhojnë Arkën për të vërtetuar pretendimin e tyre.”

Eksperti më kryesor në botë për këtë çështje dha kontekst të mëtejshëm për ushtrimin e regjistruar nga CIA në 1988.

“Në këtë rast, është një objektiv stërvitor i bërë sipas dëshirës,” tha ai, duke shtuar, “unë do sfidoja të gjithë seancën e praktikës si false. Askush nuk u përpoq të konstatonte vërtetësinë e materialit dhe gjithçka që u tha u pranua për meritat e saj të panjohura dhe të paverifikuara.”

McMoneagle mori në mënyrë të famshme Legjionin e Meritës për përdorimin e shikimit në distancë për të identifikuar një anije luftarake sekrete ruse që po zhvillohej në një ndërtesë pa dalje në det gjatë Luftës së Ftohtë.

“Aktualisht, Arka e Besëlidhjes është një përrallë legjendare. Nëse ata mund të prodhojnë Arkën aktuale bazuar në informacionin, do jetë një surprizë për mua, si dhe për shumë të tjerë,” tha McMoneagle për The Post.

Arka e Besëlidhjes thuhet se mbante Dhjetë Urdhëresate zbritura nga Moisiu nga mali Sinai.

Ky material është pronësi intelektuale e NY Post/ Përshtati Hashtag.al

Approved For Release 2000/08/08 : CIA-RDP96-00789R001300180002-7

SESSION SUMMARY

VIEWER #: 032
DATE: 5 DECEMBER 1988
START TIME: 0915L
END TIME: 1045L

Target is a container. This container has another container inside of it. The target is fashioned of wood, gold and silver. The target is similar in shape to (AOL) a coffin, and is decorated with seraphim (see sketch pg. 16).

This target is located somewhere in the Middle East as the language spoken by individuals present seemed to be Arabic. Visuals of surrounding buildings indicated the presence of Mosque Domes (?), (see page 12). Individuals in the area were clothed in virtually all white, had black hair and dark eyes -- one figure I homed in on wore a moustache.

The target is hidden -- underground, dark and wet were all aspects of the location of the target.

The purpose of the target is to bring a people together (see page 16). It has something to do with ceremony, memory, homage, the resurrection. There is an aspect of spirituality, information, lessons and historical knowledge far beyond what we now know.

The target is protected by entities (see page 14) and can only be opened (now) by those who are authorized to do so -- this container will not/cannot be opened until the time is deemed correct. Once it is time to open the container -- the mechanics of the lock system will be found to be fairly simple. Individuals opening the container by prying or striking are destroyed by the container's protectors (see page 17) through the use of a power unknown to us.

Approved For Release 2000/08/08 : CIA-RDP96-00789R001300180002-7

SECRET

PROJECT SUN STREAK

WARNING NOTICE: INTELLIGENCE SOURCES AND METHODS INVOLVED

PROJECT NUMBER: TNG *0209 SESSION NUMBER:

DATE OF SESSION: 5 DEC 88 DATE OF REPORT: 5 DEC 88

START: 0915 END: 1045

METHODOLOGY: CRY (STAGE IV TNG) VIEWER IDENTIFIER: *032

1. (S/NF/SK) MISSION: ACCESS AND DESCRIBE THE TARGET IDENTIFIED BY COORDINATE 781410/110121

2. (S/NF/SK) VIEWER TASKING: SEE MISSION STATEMENT.

3. (S/NF/SK) COMMENTS: TRAINING TARGET *0209 IS THE ARK OF THE COVENANT

4. (S/NF/SK) EVALUATION: VIEWER *032 ATTAINED EXCELLENT SITE CONTACT. DOING VERY WELL WITH STAGE IV STRUCTURE. VIEWER ALSO EXHIBITS THE ABILITY TO KEEP AOL TO A MINIMUM. HAVE TO BE CAREFUL WITH EDITING THOUGH. THIS DOES NOT SEEM TO BE A PROBLEM AT THIS TIME, JUST SOMETHING TO WATCH FOR.

Eval 4



EURO GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Montim
Servisim
Parket



Dinamo Kiev interesohet për Jasharin

Dinamo Kiev ka shfaqur interesim për ta blerë mesfushorin e Kosovës, Muharrem Jashari, por ende nuk ka asnjë ofertë zyrtare që

ka ardhur te LNZ Cherkasy. Jashari, i cili po drejton LNZ-në me golat dhe asistimet e tij, ka tërhequr vëmendjen e shumë klubeve evropiane, pasi

paraprakisht kishte interesim edhe nga LASK Linz i Austrisë. Klubi ukrainas nuk është i hapur që lojtarin ta shesë brenda kampionatit, te një rival

si Dinamo Kiev, edhe pse do të ishte hap i madh për Jasharin. Pikërisht ndaj Dinamo Kievit kishte shënuar gol Jashari. Në këtë sezon 27-vjeçari ka

shënuar 5 gola dhe ka dhënë 7 asistime në 21 ndeshje në të gjitha garat. Mesfushori i gjithanshëm nga Transfermarkt vlerësohet rreth 900 mijë euro.

Drita demolon Gjilanin, sot zhvillohen dy ndeshje



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 27 MARS - Skuadra e Dritës ka bërë një hap të madh në rrugën drejt titullit të kampiones në Superligën e Kosovës në futboll, pasi e ka mposhtur në derbi Gjilanin me rezultat 4-0. Gjilani është mbajtur mirë vetëm në 14-t minutat e parë, kur Almir

Ajzeraj e zhblokoi ndeshjen duke shënuar për 1-0. Tre minuta më vonë Rron Broja realizoi për 2-0. Në minutën e 23-të Arb Manaj realizoi golin e tretë për Gjilanin, derisa në këtë pjesë të ndeshjes realizoi edhe Denys Kostyshyn për rezultatin 4-0. Pjesa e dytë ishte më e qetë, derisa “intelektualët” shënuan edhe një gol, i cili më pas u anulua pasi Albert Dabiqaj paraprakisht luajti me dorë. Pas kësaj fitore, Drita shkon në kuotën e 57 pikëve dhe është më afër titullit të kampiones në elitë. Në anën tjetër, Gjilani mbetet në kuotën e 35 pikëve dhe do të luftojë për mbijetesë me disa skuadra të tjera. Dy ndeshje të tjera të javës së 26 në Superligë zhvillohen sot (e premte). Fillimisht nga ora 14:00 do të takohen Suhareka

dhe Malisheva. Suharekasit do të mundohen të marrin tri pikë ndaj një kundërshtari të fortë, pasi janë në pozitën e fundit dhe në garë të rreptë për mbijetesë. Ndërsa Malisheva është në pozitën e tretë dhe ka mundësi të luftojë me Ballkanin për pozitën e dytë, derisa për titull ka mbetur 16 pikë pas Dritës. Në mbrëmje Prishtina e pret Feronikelin '74. Prishtina ka shumë ndeshje pa fitore dhe në këtë ndeshje synon tri pikët e plotë, derisa “Nikli” do të luajë pa ndonjë presion sepse është në fundin e tabelës. Të shtunën mbyllet kjo xhiro me dy ndeshje, ku spikat derbi në mes të Llapit dhe Ballkanit, që zhvillohet në stadiumin “Zahir Pajaziti”, ndërsa në ndeshjen tjetër takohen Ferizaj dhe Dukagjini.

SHKURT

Mësohen gjysmëfinalistët e Kupës në hendboll

Janë luajtur ndeshjet çerekfinale të Kupës së Republikës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Ndeshja e parë ishte ajo në mes të Prishtinës dhe Besa Famgasit, ndërsa në gjysmëfinale avancoi skuadra pejane. Besa fitoi me rezultat 51:37. Në gjysmëfinale është kualifikuar edhe Kastrioti i Ferizajt që mposhti Llapin në Podujevë me rezultat 47:28. Në çerekfinalen tjetër, Vushtrria e mposhti Trepçën me rezultat 29:26. Pjesë e gjysmëfinales së Kupës është edhe Rahoveci.

KB Ylli tërhiqet nga Liga Unike, Besëlidhjes i takon vendi i tretë

KB Ylli ka vendosur të mos e zhvillojë ndeshjen kundër skuadrës nga Shqipëria, Besëlidhja, e vlefshme për vendin e tretë të këtij edicioni të Ligës Unike. Në njoftimin zyrtar të klubit nga Suhareka thuhet se këtë vendim e kanë marrë pas takimit të bordit. Arsyeja, sipas tyre, është marrë për shkak të mbingarkesës së lojtarëve. “Pas takimit të Bordit të Golden Eagle Yllit, është marrë vendimi që ekipi ynë nuk do të udhëtojë për ta zhvilluar ndeshjen për vendin e tretë në Ligën Unike. Ky vendim është marrë për shkak të mbingarkesës së lojtarëve, duke pasur parasysh që luajmë ndeshjen të shtunën në kuadër të Superligës kundër Bashkimit dhe situatën me shumë lëndime gjatë këtij sezoni, veçanërisht në javët e fundit”, thuhet në njoftim.

Scaloni: Messi vendos se a do të luajë në Kupën e Botës

Kampionët e Argjentinës po provojnë se mund të fitojnë edhe pa Lionel Messin, nëse “Pleshti” vendos të mos luajë në Kupën e Botës 2026. Pasi Argjentina siguroi vendin e saj në kompeticionin e vitit të ardhshëm me një fitore 4-1 ndaj Brazilit, pyetja e madhe tani është nëse ylli 37-vjeçar do të luajë në Botërorin e tij të gjashtë dhe do të kërkojë të fitojë dy radhazi. “Do të shohim se çfarë do të ndodhë, ka shumë kohë. Ne duhet të luajmë një lojë në një kohë, përndryshe do të flasim për të njëjtën gjë për pjesën tjetër të vitit. Duhet ta lëmë të qetë, do të shohim. Është ai që do të vendosë kur të dojë, le të mos e çmendim për këtë”, ka thënë trajneri Lionel Scaloni.

Pensionohet volejbollisti Habil Ajeti, nderohet nga FVK-ja

Tetovë, 27 mars - Në një ceremoni të veçantë të organizuar në Tetovë, volejbollisti shqiptar nga Maqedonia e Veriut, Habil Ajeti, njoftoi tërheqjen nga volejboli aktiv pas 28 viteve karrierë, njoftoi Federata e Volejbollit e Kosovës. Në këtë ngjarje morën pjesë edhe presidenti i Federatës së Volejbollit të Kosovës, Bahri Gjinovci, dhe sekretari i përgjithshëm, Valon Nikqi, të cilët e nderuan Ajetin me një

fanellë të Kombëtares së Kosovës me numrin që ai mbajti gjatë karrierës së tij. Gjithashtu, FVK-ja i dhuroi një mirënjohje për kontributin në ngritjen e volejbollit të Kosovës. I njohur për cilësitë e tij si korrektor, Ajeti ka luajtur për disa nga ekipet më të njohura të Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Zvicrës, duke dhënë kontribut të madh në zhvillimin e volejbollit shqiptar. Gjatë karrierës së tij ai

ka arritur të shpallet kampion dhe fitues i Kupës së Kosovës me ekipe të ndryshme, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në këtë sport. Ekipet ku ka luajtur Habil Ajeti: Shkëndija Tetovë, KEK-u, Mabetexi, Drenica, Rabotnički Shkup, Studenti Tiranë, Pallavolo Lugano, Shutova Kërçovë, Luboteni Ferizaj, Skënderbeu Kraishtë. Pas 28 vitesh në volejboll, Habil Ajeti largohet nga fusha, por jo nga historia e këtij sporti.



Leclerc: Duhet të ndryshojmë gjithçka për të qenë më kompetitivë

MARANELLO, 27 MARS - Charles Leclerc ka mbetur mjaft i zhgënjyer nga fundjava e kaluar në Kinë, ku të dy pilotët e Ferrarit u shkualifikuan për parregullsi. Tashmë 27-vjeçar, monegasku synon titullin kampion në Formula 1, por

me këto rezultate vështirë se kjo ëndërr realizohet. “Fundjava e kaluar ishte vërtet e vështirë për të gjithë ne. Duhet të ndryshojmë gjithçka, të punojmë më shumë për ta përmbysur situatën e keqe që kaluam në Kinë dhe jam i sigurt se do

t’ia dalim në Japoni”, u shpreh Leclerc. “Një falënderim i madh shkon për të gjithë ata që na kanë mbështetur të gjithëve si ekip gjatë fundjavës. Kjo do të thotë se ju keni shumë besim te ne për të qenë gati për garën e ardhshme”, ka shtuar

ai. Pas dy garave të para, Leclerc ende nuk është ngjitur në podium me Ferrarin. Në Maranello po punohet për të sjellë një makinë më të mirë që në garën e ardhshme në Japoni edhe pse ndryshimet më të mëdha priten në Majemi.



Gazetari gjerman zbulon: Vetëm 20 persona mund t’i afrohen Schumacherit

GJENEVE, 27 MARS - Kanë kaluar më shumë se 11 vjet qëkur legjenda e Formula 1, Michael Schumacher, pësoi aksidentin tragjik me ski në dhjetor të vitit 2013. Prej atëherë ai nuk është shfaqur më në publik dhe gjendja e tij shëndetësore mbetet mister. Sipas gazetarit gjerman të RTL, Felix Gorner, i cili konsiderohet burim i besueshëm mbi situatën e Schumacherit, ai nuk mund të komunikojë më me fjalë dhe është tërësisht i varur nga kujdestarët. “Situata është shumë e trishtueshme”, ka thënë Gorner. “Ai ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm dhe nuk mund të shprehet më me fjalë”, ka shtuar ai. Për Schumacherin, tanimë 56-vjeçar, kujdeset familja e tij dhe një ekip mjekësor në shtëpinë e tij pranë Liqenit të Gjenevës. Familja ka mbajtur gjithmonë një qëndrim të rreptë mbi privatësinë e legjendës së Formula 1, duke kufizuar qasjen tek ai vetëm për një grup të vogël njerëzish.



“Vetëm rreth 20 persona mund të afrohen te Michael”, ka shtuar Gorner. “Dhe mendoj se është strategjia e duhur, sepse familja po vepron në interesin e tij më të mirë”, ka nënvizuar ai. Mick Schumacher, djali i tij, ka ndjekur hapat e të atit në Formula 1, duke garuar për Haas më 2021 dhe 2022, por u largua nga ekipi për sezonin 2023. Ndërkohë, Elisabetta Gregoraci, ish-bashkëshortja e Flavio Briatore, ka zbuluar më parë se Schumacheri komunikon vetëm

me sytë. “Michael nuk flet. Ai komunikon me sytë. Vetëm tre persona mund ta vizitojnë dhe unë e di kush janë ata”, ka thënë ajo. Edhe në dokumentarin e Netflixit mbi jetën e Schumacherit, bashkëshortja e tij Corinna e përshkroi atë si “ndryshe”. Pavarësisht prej viteve që kanë kaluar, legjenda e F1 mbetet një figurë ikonike, me 7 tituj botërorë, 71 xhiro më të shpejta dhe 155 podiume në karrierën e tij të jashtëzakonshme.

LeBroni ua jep fitoren lakersave në sekondën e fundit

Indianapolis, 27 mars - Fitore në frymën e fundit për ekipin Lakers, që fitoi me rezultat 120-119 në fushën e Indianas. Një kosht i LeBron Jamesit në sekondën e fundit (13 pikë e 13 rebounde) i dha fitoren ekipit të tij, ndërkohë që Doniqi realizoi 34 pikë e Reaves 24 pikë. Skuadra e Denverit fitoi me shifrat 127-117 ndaj Milwaukeees në duelin e skuadrave pretendente për titull. Mungesa



e Antetokounmpo u ndie te Bucks, ndërsa Nikola Jokici realizoi një “triple double” me 39 pikë, 10 rebounde e 10 asistime. Pa probleme fitoi jashtë fushës edhe Bostoni, që mundi me rezultat 132-102 Phoenixin.

Porzingis me 30 pikë ishte lider për Celticsin. Jashtë fushës fitoi edhe skuadra e clippersave, që mundi me rezultat 126-113 New Yorkun, ndeshje ku u dalluan Hardeni me 29 pikë e Leonardo me 27 pikë.

Enzo Fernandez refuzon kalimin tek Atletico Madridi

Enzo Fernandez e ka refuzuar transferim nga Chelsea tek Atletico Madridi pavarësisht prej interesimit të madh të klubit spanjoll. Mesfushori argjentinas

mbetet i pabindur pavarësisht prej përpjekjeve të bashkëlojtarëve të tij te Kombëtarja e Argjentinës për ta joshur atë drejt një largimi nga Londra. Sipas

gazetarit të “Diario AS”, Eduardo Burgos, Fernandez tashmë ka refuzuar një qasje nga Atletico Madridi. Disa nga kolegët e tij reprezentues u përpoqën ta

bindin atë të bashkohej me skuadrën e Diego Simeones gjatë pushimit të fundit ndërkombëtar, por përpjekjet e tyre deri më tani kanë qenë të

pasuksesshme. Fituesi i Kupës së Botës thuhet se po shijon jetën në Londër dhe nuk po kërkon aktivisht një lëvizje, pasi aty është edhe kapiten i ekipit.

SHKURT

Broja pasi kaloi lëndimin, synon të shënojë gola

Pas periudhës së kombëtareve, Armando Broja është gati të kontribuojë për Evertonin. Sulmuesi kuqezi është drejt rikthimit në formë, teksa luajti 28 minuta ndaj Anglisë, ndërsa 75 minuta ndaj Andorrës, me sfidën ndaj modestëve ku dha edhe asistim. Mesazhi ishte i qartë edhe për trajnerin e ekipit të Premierë Ligës, David Moyes, me Brojën që u shpreh se mund të luajë në të gjitha pozicionet në sulm dhe se dëshiron të shënojë sa më shumë gola. Një deklaratë e tillë ka futur në mendime edhe vetë Mojesin, që me siguri nuk do të hezitojë të vendosë të luajë me lojtarin në ndeshjen e radhës. I aktivizuar në vetëm gjashtë ndeshje dhe i penalizuar për shkak dëmtimi, 23-vjeçari shihet si një “armë” e duhur për Moyes, që mund ta përdorë për ta mbyllur sezonin në mënyrën më të mirë të mundshme. Deri në fund janë edhe 9 ndeshje, me Brojën që synon ta tregojë veten. Broja është i huazuar tek Evertoni nga Chelsea deri në fund të edicionit me mundësi blerjeje.

Brazili rikthen interesimin për Ancelottin

Zhënjimi është i madh në shtëpinë e Brazilit, pas humbjes 4-1 ndaj Argjentinës. Në këto kushte drejtuesit kanë humbur besimin te trajneri Dorival, i cili mund të largohet nga drejtimi i skuadrës. Federata dëshiron Carlo Ancelottin në bankinë dhe, sipas asaj që shkruajnë mediet, synohet një takim me teknikun në fjalë (Brazili e ka kërkuar edhe më parë). Vështirë të ketë të reja në këtë periudhë, pasi trajneri italian nuk do të largohet nga Real Madridi pa përfunduar sezoni.

Aguero: Haaland do ta thyejë rekordin tim te City

Sergio Aguero beson se Erling Haaland do ta thyejë rekordin e golave te Manchester City. Argjentinasi është shënuesi më i mirë në historinë e “Qytetarëve”, me 260 gola në 10 vitet që qëndroi në “Etihad”. Por Haaland ka shënuar 119 gola në vetëm tri sezone në Manchester dhe pak muaj më parë firmosi një kontratë 9.5-vjeçare, e cila, nëse do të respektohet deri në fund, me shumë mundësi do ta shohë atë të bëhet shënuesi më i mirë i klubit. Kur u pyet për mundësinë që norvegjezi ta thyente rekordin e tij, Aguero për “Mirror” është përgjigjur: “Shpresoj që po! Ai është një lojtar i madh. Ai është shumë pranë. Mendoj se ai mund të jetë ai që do t’u afrohet golave që kam, apo edhe do të më kalojë”.

Bastoni është mbrojtësi më i shtrenjtë në botë

Alessandro Bastoni po kalon momentin më të mirë në karrierën e tij. Mbrojtësi italian po kalon një formë fantastike tek Interi, ndërkohë që për trajnerin Simone Inzaghin është thjesht i pazëvendësueshëm. Bastoni e ka dërguar paraqitjen e tij në një tjetër nivel, kjo reflektohet edhe te shifrat pasi, sipas “Trasfermarkt”, sot për sot futbollisti “zikaltër” është mbrojtësi më i shtrenjtë në botë. Kartoni i tij vlerësohet nga faqja e specializuar për statistikat me 80 milionë euro. Bastoni ndan vendin e parë me mbrojtësin e Arsenalit, Saliba. Arsenali ka në dispozicion një tjetër mbrojtës me vlerë të lartë si Gabriel, që vlerësohet 75 milionë euro. Në vendin e katërt renditet mbrojtësi i Barcelonës, Pau Cubarsi, i cili vlerësohet 70 milionë euro.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër:649/1
Datë: 27.03.2025

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës se Kosovës nr. 7/26 Mars),në bazë të Ligjit Nr. 04/I-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës te dt. 29.03.2022 së shkollës Sh M L P “Qendra e Kompetencës”, në Prizren shpallë:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të ShMLP “Qendra e Kompetencës” në Prizren, në Republikën e Shqipërisë

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t’i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet te ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjensioni duhet të ketë një dëshmi për marreveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit (**KA të klasëve të 12-ta e ka preferuar javën e katërt të muajit Prill – 4 netë e 5 ditë – 22.04.2025-26.04.2025**)
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskusionit.
- Agjencioni turistik duhet t’i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t’i mbuloj të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulutor-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2022-2023-2024)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

Kushtet tjera:

- *Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,*
- *Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në eskursion,*
- *Hoteli të posedojë sallë për ballo,*
- *Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike*
- *Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),*
- *Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrësi i vjetër,Shkodër, Krujë, Berat, Vlorë etj.*

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme:

- Çmimi ofertues
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat
- Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 14:00.
- Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfituesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje te shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t’i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. nderta MASHT-i II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus nje ditë), ndërsa agjenda mund të ndërroj varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Taboo Bar” SH.P.K. me seli në Gjilan, Burim Bexheti dhe Bardhyl Bexheti ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811312735 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Taboo Bar” D.O.O. Gnjlane, Burim Bexheti dhe Bardhyl Bexheti donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811312735 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Taboo Bar” L.L.C. with headquarters Gjilan, Burim Bexheti dhe Bardhyl Bexheti has come to the decision to quit its business: 811312735 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gjafer Fazliu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë

- Alban Ferati shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.u. në Randobrav të shkollës “22 Dëshmorët”.

- Hasime Cukaj shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës.

- Adil Morina shpall të pavlefshme diplomën e shkollës fillore “Anadolu” Mamushë.

- Leutrim Abdullahu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” Prishtinë, 2009/2010.

- Edmonda Gjaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Donjeta Avdyli Shishmon Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Durim Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti,

banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 27.03.2025 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike
T-25-4

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.
Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000
Personi Kontaktues: Besim Xhemajli
E-mail: besim.xhemajli@trepcasha.com
Telefoni: +383 28 538 050
Faks: +38 28 539 202

Shpallja Publike

- Qëllimi i ofertës:
- Dhënie me qera e hapësirave dhe objekteve
 - Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

Loti 1

Nr	Objekti	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	Porta për qëndrim te depoja e bombolave	20.00	2.50	50	9.000	4.50	54.50
2	Sipërfaqe e pambuluar te depoja e bombolave	1100.00	0.40	440	79.200	39.60	479.60

Loti 2

Nr	Objekti	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	Oborri i repartit te Zallitjes	300.00	0.40	120	21.600	10.80	130.80

Loti 3

Nr	Objekti	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	Depoja e Elektro-puntorisë	550.00	0.70	385	69.300	34.65	419.65

Loti 4

Nr	Objekti	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	Parcela P-71208128-01076-1 (Pjesërishtë)	750.00	0.59	442.5	79.650	39.83	482.33

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë
Data e shpalljes: 27.03.2025
Sqarimi: deri me 11.04.2025
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 12.03.2025
Bëhet në Zyrën e shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 11.04.2025 në 11:00
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofruesit vendor)
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.
Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.
Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.
Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.
Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1

OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Llogaritja e vlerës së qerasë		
a	Sipërfaqja e mbuluar m²	
b	Çmimi për metër katrorë (€)	
c = b*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)	
D=a*c	Vlera e qerasë për sipërfaqen e mbuluar (€)	
e	Sipërfaqja e pa mbuluar m²	
f	Çmimi për metër katrorë (€)	
g = f*18%	Çmimi për metër katrorë me TVSH (€)	
H=e*g	Vlera e qerasë për sipërfaqen e pa mbuluar (€)	
I=D+H	Gjithsejt qeraja (€)	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës se paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.
Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbytësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 11.04.2025 në Zyren e Shitjes.

Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale “ashtu siç janë dhe ku janë” dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e asetëve.

Objekti është i ndarë në lote,
Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS

Oferta duhet të jepet për m² dhe llogaritja përfundimtare në faturim.



Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 24 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.275 dhe nr. 313 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

Pozita:	Ekspert i Auditorit në fushën e ndërtimtarisë
Numri i referencës:	EA/ZKA/08-03/25
Grada:	ZKA-Z1
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat Kryesore:

- Siguron që projekti i ndërtimit përputhet me kërkesat ligjore dhe rregulloret e ndërtimit, përfshirë lejen e ndërtimit dhe standardet e sigurisë;
- Merr pjesë në auditime në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA), legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të ZKA-së, si dhe mbështet ekipet e auditimit në fushën e ndërtimtarisë;
- Përcjellë dhe vlerëson koston e projektit të ndërtimit, përfshirë materialet, pagat, shërbimet dhe shpenzimet e tjera, duke siguruar që ato të jenë të justifikuara dhe të përputhen me buxhetin e miratuar;
- Analizon punën e kontraktorëve dhe furnizuesve të ndryshëm të natyrës së ndërtimtarisë për të verifikuar nëse kanë përmbushur kushtet dhe standardet e kontratave;
- Përcjellë përdorimin e materialeve të ndërtimit për të siguruar që ato përputhen me standardet dhe kërkesat e kontratës dhe të cilësisë;
- Përcjellë dhe vlerëson se projekti është në përputhje me afatet kohore të përcaktuara dhe që nuk ka vonesa të paarsyeshme që mund të ndikojnë në kostot dhe cilësinë e projektit;
- Identifikon rreziqe që mund të ndikojnë në realizimin e projektit, përfshirë rrezikun financiar, ligjor ose operacional, dhe sugjeron masa për t'i menaxhuar këto rreziqe;
- Përcakton se të gjitha shpenzimet dhe aktivitetet janë të dokumentuara në mënyrë të qartë dhe të hapur, duke parandaluar mundësinë e mashtrimeve dhe korrupsionit;
- Bënë vlerësimet profesionale lidhur me projektet e punuara dhe krahasimin e tyre me ndërtimet e bëra;
- Vlerëson dokumentacionin teknik ndërtimor me theks të veçantë kushtet teknike të objekteve ndërtimore;
- Ndihmon në sigurinë që materialet dhe punimet e ndërtimit të jenë të standardeve të kërkuara;
- Ndihmon në parandalimin e gabimeve dhe mashtrimeve duke ofruar gjykime dhe konkluzione në lidhje me dyshimet e mundshme për mashtrim që mund të ndodhë gjatë fazës së projektimit dhe ndërtimit;
- Vlerëson praktikën e sigurisë në punë, duke ofruar konkluzione që rregullat për mbrojtjen e punëtorëve janë duke u ndjekur dhe zbatuar;
- Harton raporte cilësore për gjetjet dhe rekomandimet e tij për të informuar Ekipin e auditimit;
- Mbledhë informacione dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme që sigurojnë bazë të duhur për mbështetje të opinionit apo konkluzionit të auditimit;
- Angazhim të tjera të nevojshme lidhur me ndërtimet duke përfshirë ofrimin e njohurive profesionale dhe sqarimeve për nevojat e auditimit, etj; dhe
- Detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe të ngarkuara nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt apo i nivelit më të lartë në hierarki organizative.

Kërkesat e përgjithshme formale, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në fushën e ndërtimtarisë;
- Përvoja profesionale: Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në projektim, menaxhim, vlerësim ose mbikëqyrje të projekteve në fushën e ndërtimtarisë.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathtësi në organizim të punës dhe përmbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Aftësi motivuese dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **12.04.2025 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, kao i Člana 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije, vezano sa Članom 24 Pravilnika (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji radnih mesta; Godišnjem planu regrutacije za 2025. godinu, kao i Odlukom Generalne revizorke br.275, i br. 313 za popunu slobodnog radnog mesta Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

Pozicija:	Stručnjak revizora u oblasti građevinarstva
Referentni broj:	EA/ZKA/08-03/25
Rang:	ZKA-Z1
Broj pozicija:	Jedna (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Glavni zadaci:

- Osigurava da je građevinski projekat u skladu sa zakonskim zahtevima i građevinskim propisima, uključujući građevinske dozvole i sigurnosne standarde;
- Učestvuje u revizijama u skladu sa Međunarodnim standardima vrhovnih institucija revizije (MSVIR), važećim zakonodavstvom i internim aktima NKR-a i podržava revizorske timove, u oblasti građevinarstva;
- Prati i procenjuje cenu izgradnje projekta, uključujući materijale, plate, usluge i druge troškove, osiguravajući da su oni opravdani i u skladu sa odobrenim budžetom;
- Analizira rad različitih izvođača i dobavljača u građevinskoj industriji kako bi se proverilo da li su ispunili uslove i standarde ugovora;
- Prati upotrebu građevinskog materijala kako bi osigurao da je u skladu sa standardima i zahtevima ugovora i kvaliteta;
- Prati i vrednuje da li je projekat u skladu sa utvrđenim vremenskim rokovima i da nema neopravdanih kašnjenja koja mogu uticati na troškove i kvalitet projekta;
- Identifikuje rizike koji mogu uticati na realizaciju projekta, uključujući finansijske, pravne ili operativne rizike, i predlaže mere za upravljanje tim rizicima;
- Utvrdjuje da su svi troškovi i aktivnosti jasno i transparentno dokumentovani, sprečavajući mogućnost prevara i korupcije;
- Vrši profesionalne procene u vezi sa urađenim projektima i upoređuje ih sa izvedenim građevinama;
- Procenjuje tehničku dokumentaciju građevinskog projekta sa posebnim naglaskom na tehničke uslove građevinskih objekata;
- Pomaže u obezbeđivanju da materijali i građevinski radovi zadovoljavaju tražene standarde;
- Pomaže u sprečavanju grešaka i prevara pružajući presude i zaključke u vezi sa mogućim sumnjama na prevaru koja bi mogla nastati tokom faze projektovanja i izgradnje;
- Procenjuje prakse zaštite na radu, dajući zaključke da se poštuju i primenjuju pravila za zaštitu radnika;
- Priprema kvalitativna izveštaja o nalazima i preporukama kako bi informisao revizorski tim;
- Prikuplja dovoljne i odgovarajuće informacije i dokaze koji pružaju odgovarajuću osnovu za podršku mišljenju ili zaključku revizije;
- Drugi neophodni angažmani vezani za izgradnju uključujući pružanje profesionalnog znanja i objašnjenja za potrebe revizije, itd.; i
- Druge poslove definisane važećim zakonima koje zadaje neposredni rukovodilac ili drugi viši nivoi u hijerarhiji.

Opšti formalni zahtevi, su:

- Obrazovanje: Diploma fakulteta iz oblasti građevinarstva;
- Profesionalno iskustvo: Pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva u projektovanju, upravljanju, ocenjivanju ili nadzoru projekata u oblasti građevinarstva.

Potrebne veštine:

- Veštine u komunikaciji i planiranju rada;
- Veštine u organizovanju rada i ostvarivanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji se sprovode u Nacionalnoj kancelariji revizije;
- Motivacione i komunikacione veštine u timu;
- Da poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Postupak prijave:

Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i kandidatima iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju predati sledeća potrebna dokumenta:

- službeni formular NKR-a za aplikaciju;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Penzionog fonda);
- potvrda iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa javne funkcije (ako se primenjuje);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenta dostavljena nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpuna će biti odbijena. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **12.04.2025 do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručanju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Njoftim për ftesë për ofertë / Shprehje Interesi Ndërmarrja Publike Lokale
"Ku'zina" Sh.A.

Për marrje të objektit me qira

Ndërmarrja Publike Lokale "Ku'zina" Sh.A. fton të gjithë të interesuarit për paraqitjen e ofertave për dhënie me qira të objekteve afariste sipas kushteve të mëposhtme:

Kërkesat:

1. Objektet potenciale duhet të identifikohen, shqyrtohen dhe të vlerësohen për përputhshmërinë e tyre me kushtet për funksionimin e ndërmarrjes.
2. Sipërfaqja minimale e kërkuar: Objekti duhet të ketë të paktën 1200 m² për të plotësuar nevojat operationale të ndërmarrjes. Së paku 1,000 m² duhet të jete si një tërësi në një etazhe, ndërsa pjesa tjetër mundet me qene e ndare. Sipërfaqja e dedikuar për kuzhine duhet të jete e qasshme për automjete që bëjnë transportimin e artikujve ushqimore dhe ushqimeve të gatshme.
3. Vendndodhja: Objektet duhet të ndodhen brenda një perimetri prej 2 km nga vendndodhja e ndërmarrjes aktuale.

Dorëzimi i ofertave:

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertat në pliko të mbyllur, të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar në selinë e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ku'zina" sh. a., rr. Egnatia, Lagjia Ulpianë, Prishtinë.

Afati për dorëzimin e ofertave është deri më datën 01 Prill 2025, ora 16:00. Ofertat e pranuar pas kësaj date nuk do të merren parasysh.

Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Leja e ndërtimit me dokumentacionin përcjellës (certifikatë e pronësisë, kopje plani, Hapësira projekti, skica të objektit dhe hapësirës së jashtme, foto);
2. Deklaratë nën betim se objekti nuk është në kontest gjyqësor dhe se nuk ka çfarëdo mase të sigurisë nga gjykatat apo organet e tjera publike;
3. Oferta financiare, çmimi për m² dhe shuma totale për një muaj, duke përfshirë të gjitha tatimet dhe obligimet e tjera;

Afati i qirasë:

Ofertuesit të suksesshëm do t'i ofrohet kontratë qiraje për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, me mundësi vazhdimi me kusht të pajtimit të dyanshëm.

Për informata të tjera apo për specifikimet teknike të kërkuara, mund të kontaktoni në adresën elektronike: kuzhinagendrore@gmail.com

NPL "Ku'zina" sh. a. mban të drejtën të kërkojë informata dokumente shtesë nga ofertuesit që do të shprehin interesimin e tyre.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L